



safejournalists.net

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor

Narrative Report North Macedonia 2022

PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

9

PARANDALIMI

21

PROCES

30

SIGURIA FIZIKE

40

Hyrje

Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (Indeksi) është mjet i bazuar në hulumtime, i krijuar për të matur dhe ndjekur ndryshimet në mjedisin përkatës social dhe politik të vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Indeksi mbështetet në të dhënat hulumtuese të grumbulluara dhe të analizuara nga partnerët e platformës [SafeJournalists.net](https://www.safejournalists.net), duke u bazuar në një procedurë hulumtuese rigorozë. Të dhënat e grumbulluara për dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të "sigurisë së gazetarëve" janë kuantifikuar dhe agreguar në një indikator të përbërë - Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, në mënyrë që të maten ndryshimet në shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat kanë ndodhur me kalimin e kohës. Në bazë të të dhënave të hulumtimit, nëntë anëtarë të Panelit Këshillues në secilin shtet¹ e kanë vlerësuar situatën dhe kanë dhënë nota për secilin nga 19 indikatorët në dimensionet si vijon:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore, të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria fizike** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe medie.

Indeksi është përpiluar në bashkëpunim me hulumtuesit e Institutit RESIS² me seli në Shkup dhe partnerët e platformës

¹ Panelin Këshillues në Maqedoninë e Veriut e përbëjnë: Sali Memed, Lejla Selman, Nikolla Oxhaklievski, Leunora Kaliqi, Zhaneta Zdravkovska, Aneta Dodevska, Goran Momirovski, Marija Mitevska dhe Ivana Nastevska.


² Hulumtuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Tosheva e kanë zhvilluar kornizën konceptuale për Indeksin dhe modelin e vlerësimit të tij, peshimi dhe llogaritja.

Safejournalists.net: Shoqatën e Pavarur të Gazetarëve të Serbisë, Shoqatën e Gazetarëve të Bosnjë dhe Hercegovinës, Sindikatën e Mediave të Malit të Zi, Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, Shoqatën e Gazetarëve të Kosovës, Shoqatën e Gazetarëve Kroat dhe një hulumtuese e pavarur nga Shqipëria³. Prej këtu vijmë në konstatimin se Indeksi është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Platformës Safejournalists.net dhe përfshin të gjitha çështjet specifike që partnerët lokal i kanë vërtetuar si relevante në kontekst të shteteve të tyre.

Viti i parë (pilot) për zhvillimin e kornizës konceptuale dhe metodologjisë së vlerësimit, grumbullimit dhe përlogaritjes së indeksit ishte viti 2020. Ky raport i referohet gjendjes në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2022 dhe paraqet përmirësimin apo përkeqësimin e gjendjes për secilin nga katër dimensionet, duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2021. Më shumë detaje lidhur me kornizën teorike dhe procedurën e zhvillimit dhe llogaritjes së Indeksit, mund ti gjeni në: (<https://safejournalists.net/safety-index/>).

3 Hulumtues i pavarur për platformën Safejournalists.net në Shqipëri është Blerjana Bino.

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE



	2021	2022		Ndryshimet e reja kryesore për secilin dimension
1. Mjedisi ligjor dhe organizativ	4.28	4.17	↓	Një pjesë e ndryshimeve të paralajmëruara ligjore në drejtim të përmirësimit të sigurisë së gazetarëve dhe punëtorëve mediatik kanë ndodhur në vitin 2022 por shqetësues është trendi i rritjes së numrit të lëndëve për shpifje dhe ofendim kundër gazetarëve dhe medimeve gjatë vitit 2022 në krahasim me vitin 2021.
2. Parandalim	3.76	3.83	↑	Gjatë vitit 2022 kishte përmirësime të theksuara në aspekt të qasjes së gazetarëve deri te masat e shpejta dhe efektive në rast të kërcënimeve dhe sulmeve. Është emëruar edhe një prokurorë e veçantë nga Prokuroria Themelore Publike, përgjegjëse për ndjekjen e procedurave në rastet ku janë të sulmuar gazetarët, ndërsa është hapur edhe një linjë e veçantë telefonike ku mund të paraqiten gazetarët.
3. Proces	3.31	3.31		Perceptimi për bashkëpunim ndërmjet institucioneve kompetente gjatë vitit 2022 ishte përmirësuar dhe rezultonte me efikasitetin e tyre në zbulimin e kryerësve të veprës së sulmit, por ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Hetimet janë kryesisht të ngadalshme dhe joefikase, ndërsa nuk është ngritur asnjë padi kundër sulmeve të caktuara ndaj gazetarëve.
4. Siguria fizike	4.17	4.09	↓	Numri i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj të sulmeve është ende e lartë në vend. Shqetësuese është tendenca e rritjes së kërcënimeve online ndaj gazetarëve gra dhe vajza.
Indeksi i sigurisë së gazetarëve	3.95	3.92	↓	

— REZYME

I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Vlerësimi i përgjithshëm për këtë indikator në vitin 2022 është pak më i keq krahasuar me vitin paraprak, kryesisht për shkak të trendit të rritjes së rasteve të ofendimeve apo shpifjeve ndaj gazetarëve dhe mediave në vitin 2022. Gazetarët as këtë vit nuk e vlerësojnë Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje si kufizues. Gjykatat nuk kanë konstatuar fajësinë e ndonjë gazetari në asnjë proces gjyqësor për ofendim dhe shpifje dhe nuk kanë marrë vendime për kompensim të dëmit për reputacion të dëmtuar.
- Ashtu si edhe një vit më parë, në vitin 2022 nuk ka pasur ndryshime në aspekt të mbrojtjes së burimeve

të gazetarëve. Ligjet ofrojnë mbrojtje të mirë dhe gazetarët ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet e tyre. Megjithatë, është i vogël numri i individëve që si informatorë i raportojnë rastet e korrupsionit tek institucionet kompetente apo te gazetarët, gjë që në pikë të fundit nuk është e favorshme për vetë gazetarinë.

- Situata sa i përket këtij indikator është pak më e keqe krahasuar me vitin e kaluar për shkak se shteti ende nuk ka ndërmarrë veprime për vendosjen e mbrojtjes ligjore ndaj të ashtuquajturave padi të pabaza kundër gazetarëve dhe mediave për t'i shtruar financiarisht (padi të SLAPP). Një praktikë e tillë është regjistruar në disa raste në vend, të cilat tregojnë qartë se bëhet fjalë për përpjekje të personave të fuqishëm që të bëjnë presion ndaj gazetarëve. Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 është rritur numri i padive të tilla SLAPP kundër gazetarëve dhe punonjësve të mediave.
- Në vitin 2022, situata sa i përket ushtrimit të lirë të profesionit të gazetarëve është pak më e keqe krahasuar me një vit më parë, kryesisht për shkak të disa rasteve të akreditimit selektiv të gazetarëve nga ana e institucioneve qeveritare, refuzimit për t'i dhënë informacione gazetarëve apo pengimit gjatë raportimit nga ngjarjet e rëndësishme. Aktive janë tri shoqata profesionale, por edhe më tej mbetet e rëndësishme të punohet për qëndrueshmërinë e tyre. Nuk ka pasur presione serioze mbi shoqatat por ka rezistencë nga pronarët apo drejtuesit e mediave private, që gazetarët të anëtarësohen në sindikatën e gazetarëve dhe të themelojnë organizata sindikaliste.
- Gjendja me të drejtat e punëtorëve dhe statusin e punës së gazetarëve nuk është përmirësuar as në vitin 2022. Një numër i madh i gazetarëve në mediat private nuk kanë nënshkruar kontrata pune, punojnë jashtë orarit të punës ose të ardhurat e tyre janë të ulëta dhe jo të rregullta. Gazetarët në mediat private kanë frikë të iniciojnë procese gjyqësore për mobing apo për mosrespektimin e të drejtave të punëtorit dhe të themelojnë organizata sindikaliste në mediat ku punojnë. Në Servisin Publik gjendja është pak më e mirë, gazetarët kanë kontrata për marrëdhënie të punës, ndërsa ekziston edhe organizata sindikaliste.

II. PARANDALIM

- Gjatë vitit 2022 kishte disa përmirësime sa i përket qasjes së gazetarëve deri te masat e shpejta dhe efektive për mbrojtjen e gazetarëve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve. Në Prokurorinë Themelore Publike është caktuar një prokurore speciale, përgjegjëse për monitorimin e proceseve në raste ku të sulmuar janë gazetarët, si dhe është hapur një linjë e veçantë telefonike në të cilën mund të paraqiten gazetarët. Megjithatë, linja telefonike në Ministrinë e Brendshme, e vendosur për

denoncimin e sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2018, nuk funksionoi as në vitin 2022. Prej shtatë sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve, vetëm dy kanë përfunduar me aktvendim gjyqësor ku sanksionohen sulmuesit.

- Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndryshime në aspekt të qasjes së gazetarëve në masat për mbrojtje fizike në raste të kërcënimeve serioze për sigurinë e tyre. Nuk është mjaftueshëm e qartë se si një procedurë e tillë është e zbatueshme në aspekt praktik. Ekzistojnë dispozita ligjore, por procedura për vlerësimin e rrezikut nuk është e përcaktuar në mënyrë të qartë.
- Gjendja lidhur me këtë indikator nuk ka ndryshuar në vitin 2022. Përkundër masave të inkuorporuara në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, në praktikë nuk është krijuar ende një mekanizëm për ndihmë juridike falas për çdo viktimë të sulmeve dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe gazetaret. Në vitin 2022, në SHGM është raportuar vetëm një kërcënim ndaj një gazetareje edhe pse numri i tyre realisht është shumë më i lartë.
- Ka një përkeqësim të lehtë të gjendjes për sa i përket këtij indikator, pasi janë regjistruar shembuj të sulmeve verbale ndaj gazetarëve nga bartësit e funksioneve publike. Ndryshe, vlerësimi i përgjithshëm është se në vitet e kaluara është krijuar praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve, por ka mungesë konsistence për një praktikë të tillë tek të gjithë përfaqësuesit relevant politikë dhe qeveritarë. Bartësit e funksioneve publike kryesisht përmbahen nga sulmet verbale ndaj gazetarëve, me përjashtim të rasteve individuale.
- Policia gjatë vitit 2022 ka treguar sjellje korrekte ndaj gazetarëve dhe mediave në situata të ndryshme, kështu që situata në këtë indikator pak është përmirësuar. Po veprohet me kujdes që në trajnimet e përbashkëta me policët të përfshihen tema të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, ndërsa standardet ndërkombëtare për sjelljen e policisë ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave janë inkuorporuar në ligjet dhe kodet sipas të cilave punon policia.

III. PROCES

- Perceptimi për bashkëpunimin mes institucioneve kompetente në vitin 2022 është përmirësuar dhe ka rezultuar në efikasitetin e tyre për zbulimin e autorëve të sulmeve, por akoma nuk është në nivelin e duhur. Prokurorët publikë janë tejet pasiv sa i përket nisjes së proceseve. Ende nuk janë miratuar udhëzime të veçanta të cilat mund të ndihmojnë për zhvillimin sa më efikas të hetimeve. Një ndryshim pozitiv i vogël është emërimi i

prokurores së posaçme kompetente e cila do të monitorojë procedurat në lëndët ku të sulmuar janë gazetarët.

- Edhe pse mosndëshkimi vazhdon të jetë problem i madh, në vitin 2022 është arritur njëfarë progresi, kryesisht për shkak të sanksionimit të shpejtë dhe efektiv të një kërcënimi serioz dhe një sulmi fizik ndaj një gazetari dhe kameramani. Megjithatë, mbetet problemi i hetimeve të ngadalta dhe joefektive, derisa nuk është ngritur asnjë akuzë kundër sulmeve individuale ndaj gazetarëve.
- Gjatë vitit 2022 nuk është shënuar ndonjë përmirësim në mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënimet në internet, për faktin që institucionet kompetente nuk kanë reaguar mjaftueshëm shpejt dhe me efikasitet për gjetjen dhe sanksionimin e autorit të kërcënimit të rëndë për jetë, të dërguar online përmes rrjetit social Twitter.
- Gjendja sa i përket transparencës së proceseve gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët është e njëjtë. Gjykatat Themelore Civile dhe Penale në Shkup nuk japin informacione të detajuara për sa i përket proceseve gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve. Gjykatat nuk kanë praktikë të informimit të opinionit për procedurat që kanë të bëjnë me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave. Sistemi ekzistues i informacionit nuk ofron mundësi për një kërkim të saktë të proceseve të kaluara dhe aktuale në të cilat palë janë gazetarë.
- Nuk ka ndryshuar gjendja në krahasim me vitin e kaluar. Gjykatat dhe institucionet kompetente edhe përkundër iniciativave të SHGM-së, ende nuk kanë krijuar sisteme cilësore statistikore, në bazë të cilave mund të japin të dhëna të sakta për të gjitha proceset gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët apo media.

IV. SIGURIA FIZIKE


- Në vitin 2022 kishte një përmirësim të lehtë sa i përket këtij lloji të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave në vend. Për dallim nga viti 2020 dhe viti 2021, kur SHGM regjistroi shtatë, respektivisht tre sulme të këtij lloji, në vitin 2022 u regjistruan vetëm dy sulme ndaj gazetarëve. Krahasuar me këto dhjetë sulme të këtij lloji gjatë dy viteve të fundit në vitin 2020 dhe në vitin 2021, vetëm dy kanë epilog gjyqësor. Kjo tregon qartë se në vendin tonë shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj të sulmit është ende e lartë.
- Duke pasur parasysh se nga këto katër sulme të këtij lloji në dy vitet e fundit në vitin 2020 dhe vitin 2021, vetëm në njërin rast është ndërmarrë masë nga Prokuroria dhe aktualisht procedura vazhdon. Konkretisht, bëhet fjalë për rastin e vitit 2021, kur një person fizik, Arben Esati në profilin e tij në Facebook kërcënon disa media online. Edhe në këtë rast është evidente se në vendin

tonë shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj të sulmeve mbetet e lartë. Ndryshe nga viti i kaluar, kur SHGM regjistroi vetëm një rast, në vitin 2022 u regjistruan dy raste të kërcënimit për jetën dhe sigurinë e gazetarëve.

- Krahasuar me vitin 2021, kur SHGM regjistroi vetëm një sulm të këtij lloji, në vitin 2022 ka pasur rritje, pra janë regjistruar tre sulme të këtij lloji. Në vitin 2022 është vërejtur një praktikë pozitive me zbatimin e hetimeve dhe veprimeve të autoriteteve gjyqësore në vend. Ndryshe nga dy vitet e mëparshme, 2020 dhe 2021, kur nga tre sulme të raportuara të këtij lloji nuk kishte asnjë epilog gjyqësor, në vitin 2022, për rastin e gazetarit Nevri Ademi dhe kameramanit Zbulim Maksuti, ekziston aktvendim gjyqësor për sulmuesin.
- SHGM gjatë vitit 2022 nuk ka regjistruar asnjë sulm të këtillë. Krahasuar me vitet e kaluara, në këtë dimension, për këtë indikator situata mbetet e njëjtë.

Mjedisi ligjor dhe organizativ

4,17



Dispozitat ligjore që lidhen me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte të frikës ndaj gazetarëve dhe medieve

**Rezultati për vitin 2021: 4.58 /
Rezultati për vitin 2022: 4.34**

Vlerësimi i përgjithshëm për këtë indikator në vitin 2022 është pak më i keq krahasuar me atë të vitit paraprak, fillimisht për shkak të trendit të rritjes së numrit të lëndëve për ofendime apo shpifje ndaj gazetarëve dhe mediave në vitin 2022. Gazetarët as këtë vit nuk e vlerësojnë si kufizues Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje. Gjykatat nuk kanë vërtetuar fajësinë e gazetarit në asnjë proces gjyqësor për shpifje apo ofendim dhe nuk kanë dhënë verdikt si dëmshpërblim të dëmit për cenim të imazhit dhe nderit.

Veprat e ofendimit dhe shpifjes u de-kriminalizuan njëmbëdhjetë vjet më parë, me miratimin e Ligjit për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje (LPCOSH). Nga analiza e zbatimit të këtij ligji gjatë viteve të fundit, vlerësimi i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe ekspertëve juridikë është se paditë për ofendime dhe shpifje, me disa përjashtime, nuk kanë shkaktuar presion mbi gazetarinë profesionale. Megjithatë, sipas SHGM-së, teksti i LPCOSH -së përmbante disa dispozita të paqarta, veçanërisht në aspekt të kompensimeve për dëmin jo-material të cilat ishin shumë të larta dhe mund të shkaktinin efekt negativ në punën e gazetarëve. Prandaj, në vitin 2020 janë propozuar ndryshime dhe plotësime në këtë ligj, lidhur me tri çështje kyçe:

(1) saktësimin e definicionit për veprat e ofendimit dhe shpifjes, si vepra të nxjerra në publik, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

(2) zvogëlimi i shumave për kompensimin e dëmit (pothuajse një reduktim dhjetëfish), (3) specifikimi i mëtejshëm i përgjegjësisë për shpifje, në kuptimin që përveç gazetarit, për ofendim ose shpifje mund të përgjigjet edhe autori i deklaratës, redaktori i medias apo personi që e zëvendëson atë, si dhe personi fizik që ka në pronësi mediumin. Edhe pse këto ndryshime

— INDIKATORI 1.1

u propozuan në vitin 2020, ato u votuan nga Kuvendi tek në nëntor të vitit 2022 dhe tashmë kanë hyrë në fuqi.

Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Civile Shkup, në vitin 2022, numri i padive për ofendim dhe shpifje është rritur, kështu që numri i përgjithshëm i lëndëve aktive në të cilat palë është gazetari apo media është rritur në 54, për dallim nga viti 2021 kur shënonte 20. Gjatë vitit 2022, si dhe në vitet e mëparshme, SHGM nuk ka regjistruar asnjë procedurë gjyqësore të përfunduar në të cilën është dënuar një gazetar ose është marrë një vendim gjyqësor sipas të cilit gazetari duhet t'i paguajë paditësit dëmshpërblim për dëmin jo-material për shkak të dëmtimit të imazhit dhe dinjitetit. Krahas kësaj, vetë gazetarët nuk e vlerësojnë Ligjin si kufizues, pasi deri në vitin 2021 numri i rasteve ndaj gazetarëve dhe mediave është ulur, por shqetësuese në vitin 2022 mbetet rritja e numrit të padive kundër gazetarëve.

Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislativ ndërsa respektohet edhe nga autoritetet

Rezultati për vitin 2021: 4.37 / Rezultati për vitin 2022: 4.21

Sa i përket këtij indikator gjendja është disi më e keqe krahasuar me vitin e kaluar për shkak se shteti ende nuk ka ndërmarrë aktivitete për të vendosur mbrojtje ligjore ndaj të ashtuquajturve padi të pabaza kundër gazetarëve dhe mediave me qëllim të shterimit financiar (padi të SLAPP). Një praktikë e tillë është regjistruar në disa raste në vend, që në mënyrë të qartë tregon se bëhet fjalë për përpjekje të personave me pushtet dhe fuqi të bëjnë presion ndaj gazetarëve. Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 është rritur numri i padive të tilla SLAPP kundër gazetarëve dhe punëtorëve të mediave..

Në vitin 2022 nuk janë vërejtur shembuj të zbatimit diskriminues apo arbitrar të ligjeve të tjera me qëllim që të kufizohet liria e punës së gazetarëve. Nuk u regjistruan as tentativa për të mbyllur gojën e gazetarëve, bazuar në zbatimin arbitrar të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me përhapjen e dezinformatave, frikës, panikut apo të ngjashme. Në vitin 2022 nuk është regjistruar asnjë rast i vetëm i rrezikimit të sigurisë së gazetarëve gjatë raportimit nga protestat.

Megjithatë, ajo që mbetet shqetësuese është rritja e numrit të padive që kanë për qëllim presionin, frikësimin apo shterimin financiar të personave të pandehur, në këtë rast gazetarëve, me qëllim që të demotivohen apo të heqin dorë nga kritika publike (padi të SLAPP). Këto procese gjyqësore, sidomos kur iniciohen nga politikanët dhe bartësit e funksioneve publike, mund të shkaktojnë efektin e auto-censurës tek gazetarët. Gjatë vitit 2022, SHGM regjistroi pesë raste të tilla, të gjitha të lidhura me video-storjet hulumtuese të Investigative Reporting Lab: "Sekretet Zvicerane " (krim financiar) dhe "Gjaku i Papastër" (trajtimi mjekësor i pacientëve gjatë pandemisë së virusit korona). Në vendin tonë nuk ekzistojnë

— INDIKATORI 1.2

mekanizma mbrojtës ligjor të cilat i mbrojnë gazetarët nga paditë e këtilla. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ofron ndihmë juridike falas dhe mbulimin e shpenzimeve të avokatëve për gazetarët dhe mediat e paditura.

Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik që të punojnë në mënyrë të lirë dhe të sigurt

Rezultati për vitin 2021: 4.37 / Rezultati për vitin 2022: 4.21

Sa i përket këtij indikator gjendja është disi më e keqe krahasuar me vitin e kaluar për shkak se shteti ende nuk ka ndërmarrë aktivitete për të vendosur mbrojtje ligjore ndaj të ashtuquajturve padi të pabaza kundër gazetarëve dhe mediave me qëllim të shterimit financiar (paditë SLAPP). Një praktikë e tillë është regjistruar në disa raste në vend, që në mënyrë të qartë tregon se bëhet fjalë për përpjekje të personave me pushtet dhe fuqi të bëjnë presion ndaj gazetarëve. Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 është rritur numri i padive të tilla SLAPP kundër gazetarëve dhe punëtorëve të mediave.

Në vitin 2022 nuk janë vërejtur shembuj të zbatimit diskriminues apo arbitrar të ligjeve të tjera me qëllim që të kufizohet liria e punës së gazetarëve. Nuk u regjistruan as tentativa për të mbyllur gojën e gazetarëve, bazuar në zbatimin arbitrar të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me përhapjen e dezinformative, frikës, panikut apo të ngjashme. Në vitin 2022 nuk është regjistruar asnjë rast i vetëm i rrezikimit të sigurisë së gazetarëve gjatë raportimit nga protestat.

Megjithatë, ajo që mbetet shqetësuese është rritja e numrit të padive që kanë për qëllim presionin, frikësimin apo shterimin financiar të personave të pandehur, në këtë rast gazetarëve, me qëllim që të demotivohen apo të heqin dorë nga kritika publike (paditë SLAPP). Këto procese gjyqësore, sidomos kur iniciohen nga politikanët dhe bartësit e funksioneve publike, mund të shkaktojnë efektin e auto-censurës tek gazetarët. Gjatë vitit 2022, SHGM regjistroi pesë raste të tilla, të gjitha të lidhura me video-storjet hulumtuese të Investigative Reporting Lab: "Sekretet Zvicerane" (krim financiar) dhe "Gjaku i Papastër" (trajtimi mjekësor i pacientëve gjatë

— INDIKATORI 1.3

pandemisë së virusit korona). Në vendin tonë nuk ekzistojnë mekanizma mbrojtës ligjor të cilat i mbrojnë gazetarët nga paditë e këtilla. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ofron ndihmë juridike falas dhe mbulimin e shpenzimeve të avokatëve për gazetarët dhe mediat e paditura.

Gazetarët janë të lirë që të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre

Rezultati për vitin 2020: 4.32 / Rezultati për vitin 2021: 4.14

Në aspekt të ushtrimit të lirë të profesionit të gazetarit, gjendja në vitin 2022 është përkeqësuar në krahasim me një vit më parë, kryesisht për shkak të disa rasteve të akreditimit selektiv të gazetarëve nga ana e institucioneve qeveritare, refuzimit që të japin informacione për gazetarët apo pengimit gjatë raportimit nga ngjarjet e rëndësishme. Aktive janë tri shoqata profesionale, por vazhdon të jetë e rëndësishme që të punohet për qëndrueshmërinë e tyre. Nuk ka pasur presione serioze mbi shoqatat, por ka rezistencë nga pronarët apo drejtuesit e mediave private, që gazetarët të anëtarësohen në sindikatat e gazetarëve dhe të themelojnë organizata sindikaliste.

Në vitin 2022 nuk është regjistruar asnjë rast që një gazetar të jetë penguar apo refuzuar të raportojë nga ndonjë ngjarje, për shkak se nuk ka pasur akreditim ose dokument tjetër. Megjithatë, SHGM ka vërejtur raste të akreditimit selektiv të gazetarëve nga ana e Qeverisë, për ngjarje të organizuara nga Qeveria, ministritë dhe institucionet tjera qeveritare. Gjithashtu, kishte situata kur përfaqësues të institucioneve publike refuzonin t'u jepnin informacione gazetarëve ose ua bënë "të vështirë" raportimin nga ngjarjet e rëndësishme. Karakteristik është rasti me sjelljen e gjyqtarës Natasha Todorova nga Gjykata Civile në Shkup ndaj gazetarit Kristijan Landov, gjatë seancës kryesore për një lëndë ku palë ishin agjencia Makfax dhe media A1on.mk. Para fillimit të seancës, gjyqtarja i kërkoi Landovit letrën identifikuese të gazetarit dhe pasi që u konstatua se ajo ishte lëshuar në mënyrë të duhur nga punëdhënësi, ai u ul në seksionin e veçuar për publikun. Kur gjyqtarja përfundoi me evidentimin e të pranishmëve të tjerë, kërkoi me ton të lartë nga ai që të mos regjistronte, të mbyllte kompjuterin dhe të largohej nga salla e gjyqit. Landovi u përgjigj

se nuk po regjistronte dhe se kishte për qëllim vetëm të merrte shënime në kompjuter në mënyrë që të mund të transmetonte me saktësi pjesë të dëgjimit publik. Gjyqtarja i është drejtuar përsëri me ton të lartë, me fjalët: "Nuk keni ju pse të kapni shënime, gjykata mban procesverbal, jo ju. Mblidhni gjithçka!". Për këtë rast, gazetari Landov, me mbështetjen e SHGM-së, ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor për sjelljen e gjykatëses.

Para vitit 2019, në proceset gjyqësore për ofendim dhe shpifje, gazetarët që punonin në mediat online nuk kishin të njëjtin trajtim si gazetarët e mediave tradicionale, pasi që sipas interpretimit të gjykatave mediat online nuk mbuloheshin me Ligjin për Media dhe si rrjedhojë nuk mund të konsideroheshin si medie. Në maj të vitit 2019, katër gjykatat e apelit në RMV sollën një konkluzion, sipas të cilit mediat online, të cilat paraqiten si palë në proceset për ofendim dhe shpifje para gjykatave civile të shkallës së parë, duhet të kenë trajtim të njëjtë si mediat tradicionale. Por në prill të vitit 2021, Gjykata Themelore Civile në Shkup nuk e përfilli këtë konkluzion dhe e refuzoi padinë e gazetarit Goran Trpenoski, i cili më 27 prill të vitit 2017, gjatë incidenteve në Kuvendin e RMV-së raportonte për median online sdk.mk. Në aktvendim, gjykata u arsyetua se në atë kohë Trpenoski nuk ishte gazetar sepse punonte në media online dhe për këtë arsye nuk ka të drejtë për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga frika e përjetuar. I pakënaqur me aktvendimin, gazetari Trpenoski në vitin 2021 parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Shkup kundër aktvendimit të sjellë, e cila më 22 dhjetor të vitit 2022 vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazë dhe të vërtetohet verdikti i shkallës së parë.

Shumica e gazetarëve janë të organizuar në shoqata profesionale. Shoqata më e madhe dhe më e vjetër është Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), e themeluar në vitin 1946, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ) dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ). Kuvendi vjetor zgjedhor i rregullt i cili u mbajt në dhjetor të vitit 2022 ishte më masivi në krahasim me të gjitha kuvendet e mëparshme, në të cilën rreth 485 anëtarë të rregullt – gazetarë dhe punonjës të mediave – shprehën mendimin e tyre në mënyrë demokratike dhe të drejtë për të ardhmen e gazetarisë në vend.

Gazetarët dhe punëtorët e mediave janë të organizuar edhe në kuadër të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatik – SPGPM që është e pavarur dhe nuk është pjesë e asnjë organizate sindikale në nivel kombëtar. Ekziston edhe një sindikatë e veçantë e Servisit Publik, e cila nuk është pjesë e SPGPM-së. SPGPM është themeluar në vitin 2010 dhe është anëtare e plotë e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ), si dhe e Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ). SPGPM bashkon gazetarë, video dhe fotoreporterë, si dhe punonjës të tjerë të mediave të cilët janë të përfshirë në procesin e prodhimit të përmbajtjeve mediatike. Aktualisht, SPGPM numëron mbi 300 anëtarë aktivë. Sipas përfaqësuesve të SPGPM-së, pronarët dhe drejtuesit e shumicës së mediave

— INDIKATORI 1.4

private (veçanërisht disa prej televizioneve në nivel shtetëror) ushtrojnë forma delikate të pengimit të gazetarëve që të anëtarësohen në sindikatën e gazetarëve ose të themelojnë organizata sindikale në kuadër të mediave ku punojnë.

Ekziston edhe Këshilli i Etikës në Media (KEMM), i cili u themelua në dhjetor të vitit 2013. KEMM është trup vetërregullues në të cilin në mënyrë vullnetare janë anëtarësuar një numër i madh i mediave radiodifuzive, të shkruara dhe online. KEMM nuk përballet me presione serioze, por ky organ është ende i pambrojtur për shkak të problemeve që lidhen me qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e tij në terma afatgjatë. Prandaj, ky organ njësoj si shoqatat tjera të gazetarëve (SHGM dhe SPGPM) ende ka nevojë për mbështetje të fuqishme nga komuniteti profesionist i mediave, shteti dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve.

Profesioni i gazetarit dhe gjatë vitit 2022 nuk është pre e licencimit, nuk ka pasur tentativa apo iniciativa që të vendoset çfarëdo lloji i licencimit të gazetarëve. Ligji për Media i miratuar në vitin 2013, përmban një definicion përkufizues të termit gazetar, megjithatë në praktikë nuk ka shembuj të regjistruar të kufizimit të individëve për të punuar si gazetarë.

Pozita e gazetarëve në vendin e punës është stabile dhe e mbrojtur

**Rezultati për vitin 2021: 3.34 /
Rezultati për vitin 2022: 3.34**

Gjendja me të drejtat e punëtorëve dhe statusin e punës së gazetarëve nuk është përmirësua as në vitin 2022. Një numër i madh i gazetarëve në mediat private nuk kanë nënshkruar kontrata të punës, punojnë jashtë orarit ose të ardhurat e tyre janë të ulëta dhe të jo të rregullta. Gazetarët në mediat private kanë frikë të iniciojnë procedura gjyqësore për mobing ose mosrespektim të drejtave të punës dhe të themelojnë sindikata në media. Në Servisin Publik situata është pak më e mirë, gazetarët kanë kontrata pune, ekziston edhe organizatë sindikaliste.

Edhe në vitin 2021 si në vitet paraprake, nuk mund të gjenden si në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2022 nuk u gjetën të dhëna të sakta se sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune. Në mediat private shumë gazetarë kanë kontrata me afat të caktuar kohor ose janë të angazhuar si honorarë. Përveç kësaj, ata vazhdojnë të punojnë jashtë orarit pa pagesë, si dhe punojnë pa kompensim gjatë festave dhe fundjavave. Mosrespektimi i të drejtave të punëtorit dhe të ardhurat e ulëta janë problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohet profesioni i gazetarit. Sipas të dhënave të marra nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve të Medias (SPGPM), shumica e gazetarëve kanë të ardhura mujore shumë më të ulëta se paga mesatare në vend, e cila në vitin 2021 ishte 28.869 denarë. Por sipas anketës së SPGPM -së, paga e shumicës së gazetarëve të rinj nuk e arrin as këtë shumë. Një e treta e gazetarëve të rinj të anketuar janë përgjigjur se paguhen nga 15.000 deri në 20.000 denarë, pak më shumë se dhjetë për qind janë përgjigjur se paga e tyre është nga 25.000 deri në 30.000 denarë, ndërsa një e katërta kanë thënë se kanë pagë më të lartë se 30.000 denarë. Gjendja disi është më e mirë në Servisin Publik, ku paga mesatare e gazetarëve është rreth 38.000 denarë, edhe pse konsiderohet se pagat e gazetarëve janë më të ulëta se pagat e gazetarëve në televizionet private nacionale, veçanërisht atyre me përvojë më të gjatë. Por, ndryshe nga disa media private, rregullshmëria e pagesës së pagave të e as siguria e vendeve të punës të

punëtorëve të RTM-së nuk ka qenë asnjëherë problem, e cila garantohet me marrëveshjet e nënshkuara të punës.

Vlerësimi i përgjithshëm është se pozicioni i gazetareve në redaksi nuk dallon shumë nga pozicioni i gazetarëve. Nuk ka të dhëna se sa gazetarë dhe gazetare kanë nënshkruar kontrata pune, por konsiderohet se punëdhënësit, në përgjithësi, kur bëhet fjalë për gazetaret e punësuar për një periudhë të pacaktuar, respektojnë të drejtat elementare të përcaktuara me ligj. Fakti është se diskriminimi gjinor dhe pozita jo e favorshme e grave, krahasuar me atë të burrave, në vendin e punës shpeshherë nuk njihet nga vetë gazetarët. Megjithatë, në vend ka media si MIA (Agjencia për Informim të Mediave) dhe IRL (Laboratori i Gazetarëve Hulumtues), ku gratë janë në numër më të lartë në krahasim me kolegët e tyre gazetarë dhe ato kanë rol të rëndësishëm edhe në redaksi.

Gazetarët kanë frikë të padisin redaktorët, drejtorët apo pronarët e mediave kur iu shkelen të drejtat e tyre të punëtorit. Në vitin 2022 nuk ka pasur asnjë rast të vetëm që një gazetar ka paditur një menaxher për mobing dhe nuk ka pasur vendim të plotfuqishëm për një vepër të tillë. Gazetarët zakonisht nuk marrin asistencë juridike falas në redaksi gjatë situatave kur paditen për ofendim apo shpifje. Në situata të tilla, SHGM u ofron gazetarëve ndihmë juridike dhe përfaqësim falas gjatë proceseve para gjykatave të vendit. Një numër i vogël i mediave private kanë organizata sindikale, gjegjësisht tek gazetarët ende ekziston frika apo mungesa e interesimit për organizimin sindikalist në mediat ku punojnë. Përrjashtim bën Servisi Publik, ku gazetarët janë të organizuar në një sindikatë të veçantë që nuk është pjesë e SPGPM-së. Nuk ekziston marrëveshje kolektive në media private dhe as në nivel të industrisë.



Parandalimi

3,83

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë qasje në masa mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen

3,75

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta apo integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të mbrojtjes speciale/sigurisë

3,42

Gazetarët kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

3,64

Është krijuar praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe medie

3,58

Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve

4,77

1.00
2.00
3.00
4.00
5.00
6.00
7.00



Nuk ekzistojnë mekanizma institucionale për mbrojtje direkte të gazetarëve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve apo, funksionarë nxisin sulme ndaj gazetarëve, ndërsa policët sillen skajshmërisht ashpër me gazetarët.

Janë vendosur të gjitha mekanizmat institucionale për ndihmë direkte të gazetarëve në rast të sulmeve, funksionarë i dekurajojnë vazhdimisht dhe në mënyrë publike sulmet ndaj gazetarëve, zyrtarët policor i trajtojnë gazetarët me respekt

Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik kanë qasje direkte deri tek masat mbrojtëse efektive kur janë të eksponuar ndaj kërcënimeve

Rezultati për vitin 2021: 3.34 / Rezultati për vitin 2022: 3.75

Gjatë vitit 2022, ka pasur disa përmirësime në aspekt të qasjes së gazetarëve deri te masat e shpejta dhe efektive për mbrojtjen e gazetarëve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve. Në Prokurorinë Themelore Publike është caktuar një prokurore speciale, përgjegjëse për monitorimin e proceseve të lëndëve ku janë të sulmuar gazetarët, si dhe është hapur një linjë veçantë telefonike ku mund të paraqiten gazetarët. Megjithatë, linja telefonike në Ministrinë e Brendshme e cila është vendosur në vitin 2018, për denoncimin e sulmeve ndaj gazetarët nuk funksionoi as në vitin 2022. Prej shtatë sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve, vetëm dy përfunduan me aktvendim gjyqësor me të cilin sanksionohen sulmuesit.

Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2018 vendosi linjën e parë telefonike për mbështetjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së dhe Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve të Medias (SPGPM). Qëllimi ishte mbështetja dhe këshillimi i gazetarëve dhe punonjësve mediatik në rastet e shantazheve, kërcënimeve, sulmeve verbale ose fizike, sulmeve online, dhunës me bazë gjinore, shkatërrimit të pronës private dhe profesionale dhe sulmeve në redaksitë dhe shtëpitë e gazetarëve. Mirëpo, prej më shumë se dy vitesh kjo linjë telefonike nuk funksionon dhe denoncimet për sulme online apo gjuhë të urrejtjes ndaj gazetarëve i janë dorëzuar Departamentit për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Dixhitale në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në shtator të vitit 2022, është bërë pak progres në këtë drejtim, pasi që Prokuroria Themelore Publike ka emëruar një prokurore kompetente për të monitoruar procedurat në lëndët ku janë të sulmuar apo dëmtuar gazetarët. Në Prokurorinë Publike është vendosur edhe një linjë e hapur telefonike

— INDIKATORI 2.1

përmes së cilës gazetarët mund të kontaktojnë prokurorin kompetent në lidhje me procedurat për sulme fizike dhe dhunë, si dhe për kërcënimet serioze me jetë, të dërguara përmes rrjeteve sociale. Synimi i Prokurorisë Publike të RVM-së është që në periudhën e ardhshme të caktojë prokurorë për mbrojtjen e gazetarëve në qytetet tjera të vendit.

Sipas regjistrimit të SHGM-së, në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej shtatë kërcënime dhe sulme, një prej të cilave është dërguar përmes rrjetit social Twitter. Pas denoncimit në MPB, Prokuroria Publike ka nisur një procedurë ndaj autorit të veprës penale, e cila ende po vazhdon. SHGM ka informacion se tashmë për disa raste të regjistruara janë shqiptuar aktvendime gjyqësore (për shembull për sulmin me sëpatë ndaj gazetarit dhe kameramanit si dhe sulmin ndaj kameramanit nga një person fizik). Mirëpo, sipas SHGM-së, bashkëpunimi me institucionet kompetente nuk është në nivel të kënaqshëm, hetimet nuk i kryejnë me efikasitet dhe rrallëherë i ndjekin penalisht autorët e kërcënimeve dhe sulmeve në detyrë zyrtare. Në veçanti mbetet shqetësuese gjuha e urrejtjes dhe etiketimi i gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga ana e politikanëve dhe bartësve të funksioneve tjera publike.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik (jetët apo integriteti i të cilëve është realisht në rrezik direkt) kanë qasje deri tek mekanizmat speciale për mbrojtje/siguri

Rezultati për vitin 2021: 3.42 / Rezultati për vitin 2022: 3.42

Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndryshime në lidhje me qasjen e gazetarëve në masat për mbrojtje fizike në raste të kërcënimeve serioze për sigurinë e tyre. Nuk është mjaft e qartë se si një procedurë e tillë është praktikisht e zbatueshme. Ka dispozita në ligj, por procedura për vlerësimin e rrezikut nuk është e përcaktuar në mënyrë të qartë.

Ligji për procedurë penale në RMV përmban dispozita që rregullojnë veprimet e autoriteteve gjyqësore gjatë procedurës hetimore, me qëllim që të parandalohet "personi i akuzuar që të pengojë zhvillimin dhe mbarëvajtjen e papenguar të procedurës penale dhe mbrojtjen e viktimës". Nga pikëpamja formale-juridike bëhet fjalë për masat e sigurisë të rregulluara në nenin 146 të Ligjit për Procedurë Penale, më konkretisht paragrafin 1, pika 6, ku thuhet "... 6) ndalesë për afrim apo vendosje, më konkretisht zhvillimit të kontakteve apo marrëdhënieve me persona të caktuar", dhe zbatohet vetëm kur dihet autori i veprës penale, kur ekziston kallëzim penal i caktuar dhe kur është nisur procedura. Këto masa të kujdesit propozohen nga prokurori publik, të cilat i cakton gjykatësi në procedurë paraprake, në bazë të vlerësimit të seriozitetit të situatës, llojit të veprës penale, rrezikshmërisë për viktimën etj.

Rrjedhimisht, në ligj ekziston mekanizëm i përgjithshëm mbrojtës që gazetarët mund ta përdorin në rast të ndonjë kërcënimi më serioz për jetën e tyre, por sipas ekspertëve ligjorë kjo është praktikisht e zbatueshme vetëm nëse personi që kryen kërcënimin është i njohur dhe jo në situata kur autori i kërcënimit është i panjohur. Në vitin 2022 nuk është regjistruar asnjë rast ku gazetarët kanë kërkuar vendosjen e masave për mbrojtje fizike nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gazetaret kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma për mbështetje kur ballafaqohen me kërcënime, ngacmim dhe dhunë me bazë gjinore

Rezultati për vitin 2021: 3.64 / Rezultati për vitin 2022: 3.64

Në vitin 2022, gjendja në lidhje me këtë indikator nuk ka ndryshuar. Përkundër masave të inkorporuara në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, në praktikë ende nuk është krijuar një mekanizëm për ndihmë juridike falas për çdo viktimë të sulmeve dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe gazetaret gra. Në vitin 2022 në SHGM u raportua vetëm një kërcënim ndaj një gazetareje, megjithëse numri i tyre realisht është shumë më i lartë.

Në Maqedoninë e Veriut, Konventa e Stambollit u ratifikua në vitin 2018 dhe dispozitat e saj u inkorporuan në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje i hartuar gjatë vitit 2020, i miratuar në janar të vitit 2021. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ndalon çdo lloj dhune me bazë gjinore ndaj grave dhe garanton mekanizma bazë për mbrojtje efektive të viktimave nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu, ky ligj përmban detyrimin e institucioneve për të vendosur masa parandaluese për parandalim dhe mbrojtje kundër çdo lloj dhune me bazë gjinore si dhe ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Një mekanizëm i tillë i veçantë në nivel ndërinstitucional për të ofruar ndihmë juridike për viktimat e sulmeve ose dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë edhe gazetaret, nuk është vendosur edhe gjatë vitit 2022. Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, përgjegjëse është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas praktikës së SHGM-së, gazetaret që kanë qenë viktimat të ngacmimeve, sulmeve apo kërcënimeve në bazë gjinore, deri më tani kryesisht rastet i kanë denoncuar në MPB, por edhe në SHGM. Në regjistrin e sulmeve të SHGM-së për vitin 2022, është regjistruar vetëm një denoncim nga një gazetare. Për rastet e diskriminimit në vendin e punës, gazetaret mund

— INDIKATORI 2.3

të drejtohen edhe në Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Megjithatë, sipas njohurive të SHGM-së, gazetaret rrallë herë e përdorin këtë mundësi, me shumë gjasa nga frika se mund të kenë pasoja në vendin e tyre të punës.

Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimit dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

Rezultati për vitin 2021: 3.78 / Rezultati për vitin 2022: 3.58

Ka një përkeqësim të lehtë të gjendjes për sa i përket këtij indikator, pasi që janë regjistruar shembuj të sulmeve verbale ndaj gazetarëve nga bartësit e funksioneve publike. Ndryshe, vlerësimi i përgjithshëm është se në vitet e kaluara është krijuar një praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve, por ka mungesë konsistence në një praktikë të tillë tek të gjithë përfaqësuesit relevantë politikë dhe qeveritarë. Bartësit e funksioneve publike kryesisht përmbahen nga sulmet verbale ndaj gazetarëve, me përjashtim të rasteve individuale..

Vlerësimi i përgjithshëm është se atmosfera në të cilën punojnë gazetarët në përgjithësi, duke përfshirë ata që hetojnë korrupsionin, është shumë më e lirë. Është krijuar një praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve nga bartësit e funksioneve publike, por në vitin 2022 ka edhe shembuj të kundërt të cilat janë vërejtur. Bëhet fjalë për raste kur deputetë, politikanë apo liderë të partive politike kanë zhvlerësuar apo nënçmuar publikisht gazetarët në konferenca për shtyp, mitingje partiake apo në rrjetet sociale. Shembulli më i theksuar negativ i zhvlerësimit të gazetarëve ishte ai i liderit të partisë politike E Majta, Dimitar Apasiev, i cili përdori një fjalim stigmatizues dhe fyes ndaj gazetarëve (madje edhe duke i quajtur "prostituta"), në shenjë pakënaqësie për mënyrën që ata kanë raportuar nga Konferenca Ndërqeveritare në Bruksel.

Shembulli i dytë është komunikimi i papërshtatshëm i Hristijan Mickoskit, kryetarit të partisë opozitare VMRO-DPMNE, i cili shpërfilli publikisht gazetarët që raportonin për mosmarrëveshjen bilaterale me Bullgarinë. Ai në fjalimin e tij partiak, në tubimin e mbajtur para Qeverisë në korrik të vitit 2022, përdori shprehje fyese dhe përçmuese për gazetarët: "Na kanë gënjer se nuk po negociojnë për gjuhën, se nuk

— INDIKATORI 2.4

po negociojnë për identitetin dhe sot ata të paguarit, të them të drejtën, pak pena qeveritare përmes shkrimeve të vogla, na bindin se kanë triumfuar për kushedi cilën herë". Për këto dy raste ka reaguuar SHGM, duke theksuar se etiketimi publik i gazetarëve dhe mediave, veçanërisht nga kryetarët e partive politike, ndikon negativisht në lirinë e mediave dhe kontribuon në censurë dhe auto-censurë tek gazetarët.

Zyrtarët policor janë të ndjeshëm për çështjen e mbrojtjes së gazetarëve

Rezultati për vitin 2021: 4.61 / Rezultati për vitin 2022: 4.77

Policia gjatë vitit 2022 ka treguar sjellje korrekte ndaj gazetarëve dhe mediave në situata të ndryshme, kështu që gjendja në këtë indikator është përmirësuar pak. Përkujdesen që në trajnimet e përbashkëta me policët të përfshihen tema që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, ndërsa standardet ndërkombëtare për sjelljen e policisë ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave të inkuorohen në ligjet dhe kodet në bazë të cilave punon policia.

Standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut janë të inkuoruar në Kodin e Etikës Policore, Ligjin për Policinë dhe ligje të tjera përkatëse. Trajnimi i zyrtarëve policor që zbatohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme përfshin edhe module që kanë të bëjnë me njohjen e të drejtave themelore të njeriut të përcaktuara nga marrëveshjet dhe konventat e ratifikuara ndërkombëtare. Gjithashtu, SHGM dhe Ministria e Brendshme kanë zhvilluar trajnime të përbashkëta për ti njoftuar zyrtarët policorë me rolin e gazetarëve në një shoqëri demokratike.


Në dhjetor të vitit 2017 u nënshkrua Memorandum për Bashkëpunim, ndërsa në dhjetor të vitit 2019 u vendos edhe Protokollin për Bashkëpunim mes SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, qëllimi kryesor i të cilit është zhvillimi, ruajtja dhe promovimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet punonjësve mediatik dhe zyrtarëve policorë. Në vitin 2022, bashkëpunimi mes SHGM-së dhe Ministrisë së Brendshme, gjatë organizimit të trajnimeve, u realizua me intensitet të reduktuar. Dy trajnime janë mbajtur së bashku me Departamentin për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale dhe komandantët e stacioneve policore nga Shkupi. Në vitin 2022, SHGM në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, përgatiti një Protokoll për sigurinë e gazetarëve në hapësirën online .

Në kontekst të këtij bashkëpunimi, SHGM publikoi disa doracakë, të cilët përveç gazetarëve iu dedikohen edhe zyrtarëve policorë. Gjatë vitit 2022 nuk janë regjistruar probleme më serioze në sjelljen e policisë ndaj gazetarëve dhe mediave.



Proces

3,31



30

Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

Rezultati për vitin 2021: 3.29 / Rezultati për vitin 2022: 3.43

Perceptimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kompetente në vitin 2022 është përmirësuar dhe ka rezultuar në efikasitetin e tyre në zbulimin e autorëve të sulmeve, por ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Prokurorët publikë janë shumë inertë kur bëhet fjalë për nisjen e procedurave. Nuk janë miratuar ende udhëzime të veçanta të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve në mënyrë më efektive. Ndryshim i vogël pozitiv është emërimi i prokurores kompetente të veçantë, e cila do të monitorojë procedurat në raste ku të sulmuar janë gazetarët.

Falë insistimit të SHGM-së gjatë dy viteve të fundit, në tetor të vitit 2022 kishte një ndryshim të gjendjes në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të hetimeve në raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Ndryshimi pozitiv është emërimi i prokurores Iskra Haxhi Vasilleva si prokurore kompetente, e cila do të monitorojë procedurat në rastet ku të sulmuar janë gazetarët. Përmes linjës së veçantë të vendosur për të komunikuar me Prokurorinë Publike, gazetarët do të mund të informohen për rrjedhën e procedurës për sulme fizike dhe dhunë.

Megjithatë, ende nuk ka udhëzime të veçanta të miratuara nga MPB-ja dhe Prokuroria Publike për zbulimin dhe ndjekjen efektive të autorëve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Udhëzime të pjesshme në këtë drejtim gjenden në manualet që SHGM i përpiloi në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme: "Manuali për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezikshmëri të lartë", "Udhëzimet për raportim

— INDIKATORI 3.1

profesional mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin" dhe "Protokolli i informimit për rastet e lidhura me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin". Në vitin 2022, SHGM në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, hartoi "Protokollin për sigurinë e gazetarëve (me fokus te gazetaret) në internet".

Problemi i dytë është se institucionet kompetente ende bashkëpunojnë jo mjaftueshëm dhe rrallëherë ngrenë akuza ndaj autorëve të kërcënimeve apo sulmeve, ndërsa në raste kur hetimet nisen ato zhvillohen ngadalë dhe në mënyrë joefikase. Prandaj, në komunikimin me MPB-në dhe PTHP-në, SHGM-ja insiston vazhdimisht në përforcimin e bashkëpunimit të tyre dhe personave që do të delegohen të jenë të trajnuar mirë me fokus parësor në trajtimin e rasteve të sulmeve dhe rrezikimit të sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)

Rezultati për vitin 2021: 3.32 / Rezultati për vitin 2022: 3.49

Edhe pse mosndëshkimi vazhdon të mbetet problem tejet i madh, gjatë vitit 2022 është arritur një progres i vogël, kryesisht për shkak të sanksionimit të shpejtë dhe efektiv ndaj një kërcënimi serioz dhe një sulmi fizik mbi një gazetar dhe kameraman. Megjithatë, problemi i hetimeve të ngadalta dhe joefektive mbetet dhe nuk është ngritur asnjë akuzë kundër sulmeve individuale ndaj gazetarëve.

Sipas regjistrimit të SHGM-së, që nga fillimi i vitit 2022 janë regjistruar gjithsej shtatë sulme dhe kërcënime të ashpra ndaj gazetarëve, për dallim nga viti i kaluar kur ishin regjistruar gjithsej pesë. Për sulmin e parë fizik të regjistruar në shkurt të vitit 2022, kur u sulmua kameramani dhe gazetari i TV Pollogut, është zhvilluar hetim i shpejtë i cili përfundoi me aktvendim gjyqësor për sulmuesin. Gjithashtu, në fund të vitit 2022 gjykata vendosi në favor të kameramanit të TV24 dhe dënoi sulmuesin, i cili u deklarua fajtor për sulmin fizik në gjyq. Për pesë sulmet tjera, tre prej të cilave janë raportuar në MPB, SHGM ende nuk ka informacion për ndonjë epilog gjyqësor.

Kjo tregon se mosndëshkimi është ende një problem tejet i madh, para së gjithash për shkak të kapaciteteve dhe bashkëpunimit të pamjaftueshëm me institucionet kompetente. Sa i përket policisë, një pjesë e sulmeve dhe kërcënimeve procesohen shpejtë, por më pas procedura ngec ose është shumë e ngadalshme kur duhet të ngrihen akuzat. Ndodh rrallë herë që hetimi të përfundojë me aktvendim gjyqësor me të cilin dënohen autorët e kërcënimeve apo sulmeve. Autorët e sulmeve ndaj gazetarëve zakonisht nuk përndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare, gjë që detyron gazetarët të iniciojnë padi private. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shembulli i parë pozitiv ndodhi në dhjetor të vitit 2021, kur

— INDIKATORI 3.2

u vendos një aktvendim gjyqësor me të cilin ishte shqiptuar sanksion ndaj një personi që dërgoi kërcënim serioz në internet ndaj të gjithë gazetarëve nëpërmjet faqes së SHGM-së në Facebook. Ky është shembulli i parë ku Prokuroria dhe gjykata plotësisht të hetonin dhe sanksiononin një krim të rëndë të kryer ndaj gazetarëve nëpërmjet platformës online. Rritja e efikasitetit për nisjen dhe zbatimin e hetimeve në rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve pritet të ketë përparim me emërimin e prokurores kompetente.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias mbrohen me efikasitet nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet

**Rezultati për vitin 2021: 3.46 /
Rezultati për vitin 2022: 3.46**

Gjatë vitit 2022 nuk është shënuar përmirësim për mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënimet online për shkak se institucionet kompetente nuk kanë reaguar aq shpejt dhe me efikasitet sa duhet për gjetjen dhe sanksionimin e autorit të një kërcënimi serioz për jetën, të dërguar online përmes rrjetit social Twitter.

Sipas Kodit Penal të RMV-së, sulmet online ndaj gazetarëve Sipas Kodit Penal të RMV-së, sulmet online ndaj gazetarëve mund të sanksionohen në dy baza. Së pari, sipas nenit 394-g, shpërndarja e përmbajtjeve me 'gjuhë të urrejtjes' në publik, nëpërmjet sistemit kompjuterik, kundër çdo personi ose grupi për shkaqe të ndryshme, duke përfshirë edhe 'statusin personal dhe shoqëror', dënohet me një deri në pesë vjet burg. Në këtë Nen nuk është përdorur në mënyrë eksplicite termi 'gjuhë e urrejtjes', por një përkrahje me i gjerë i përmbajtjeve të cilat përfshijnë: materiale të shkruara raciste dhe ksenofobike, fotografi ose formë tjetër e pasqyrit të idesë ose teorisë që ndihmon, promovon ose nxit urrejtje, diskriminim apo dhunë. Së dyti, sipas nenit 144, paragrafi 1, çdo kërcënim serioz për sulm ndaj jetës ose trupit të dikujt ose jetës apo trupit të personit të afërt të tij, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Përpos kësaj, sipas paragrafit 4 të nenit të njëjtë, cilido që drejton kërcënim përmes sistemit informatik, se do të kryejë vepër penale (për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë) ndaj çdo personi apo grupi mbi baza të ndryshme, duke përfshirë edhe bazën e "statusit personal dhe shoqëror", dënohet me burg nga një deri në pesë vjet. Organet e përndjekjes do të ngrenë akuza sipas pikës 4 të nenit 144 nga KP vetëm nëse ekziston kërcënim eksplicit për vepër penale për të cilin parashikohet dënim me burg mbi 5 vjet. Pikërisht për këto arsye janë propozuar ndryshime në Kodin Penal që ti mundësohet PTHP-së të veprojë dhe të ndjekë penalisht çdo lloj kërcënimi (online dhe offline) ndaj gazetarëve, me një formë të kualifikuar të kësaj vepre penale (sanksione më të rrepta për

— INDIKATORI 3.3

kërcënimet ndaj gazetarëve). Deri në fund të vitit 2022, këto ndryshime në Kodin Penal ende nuk janë miratuar në Kuvend.

Arsyeja se pse shumë raste të sulmeve ndaj gazetarëve shpesh mbetën të pazgjidhura dhe kontribuan në krijimin e një klime të mosndëshkimit ishte se gazetarët rrallë vendosnin të padisin privatisht për kërcënime ose ngacmime. Sipas statistikave të SHGM-së, numri i përgjithshëm i kërcënimeve dhe sulmeve të regjistruara në vitin 2022 ishte shtatë, njëra nga ato u dërgua nëpërmjet rrjetit social Twitter dhe ishte kërcënim për jetën e gazetarit Furkan Saliu. Kërcënimin u denoncua në Departamentin e Krimit Kompjuterik dhe Forenzikës Dixhitale në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por më pas nuk është zhvilluar asnjë hetim i mëtijshëm efektiv për sanksionimin e personit që e ka dërguar kërcënimin.

Hetimet e të gjitha llojeve të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, bëhen me transparencë

Rezultati për vitin 2021: 3.09 / Rezultati për vitin 2022: 3.09

E njëjta gjendje është edhe sa i përket transparencës së proceseve gjyqësore në të cilat palë janë gazetarë. Gjykatat Themelore Civile dhe Penale në Shkup nuk japin informacione të detajuara për procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve. Gjykatat nuk kanë praktikë që të informojnë publikun për procedurat që kanë të bëjnë me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave. Sistemi ekzistues informatik nuk ofron mundësi për kërkim preciz të proceseve të kaluara dhe aktuale në të cilat palë janë gazetarët.

Gjykatat nuk janë mjaftueshëm transparente në lidhje me zhvillimin e proceseve gjyqësore për sulme ndaj gazetarëve apo mediave. Gjyqësori është më i hapur dhe më transparent në krahasim me pesë vite më parë, por kjo ende nuk mjafton. Këto lëvizje pozitive nuk janë për shkak të përmirësimit sistematik, të një strategjie të miratuar apo një reforme të zbatuar, në drejtim të rritjes së transparencës dhe publikimit të gjyqësorit, por ndodhin më shumë për shkak të kontributit personal të individëve për të rritur shkallën e transparencës në punën e institucioneve që përfaqësojnë. Më shumë vëmendje i kushtohet mundësimit të transparencës formale sesa thelbësore në gjyqësor. Cilësia e kornizës aktuale ligjore nuk kontribuon mjaftueshëm në transparencën dhe hapjen optimale të sektorit të drejtësisë. Gjykatat Themelore Civile dhe Penale në Shkup nuk japin informacione të detajuara për procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë viteve të kaluara. Gjykatat nuk kanë praktikë të informojnë publikun për procedurat që zhvillohen kundër gazetarëve apo në të cilat gazetarët janë palë si subjekt i sulmeve apo kërcënimeve.

Sistemi informatik i automatizuar për menaxhim me raste (AKMIS) nuk ofron mundësi për kërkim të saktë të procedurave të kaluara dhe aktuale në të cilat palë janë gazetarë dhe

— INDIKATORI 3.4

në këtë mënyrë publiku e ka më të vështirë qasjen në këto informacione. Gjatë vitit 2021, SHGM ka arritur të marrë vetëm informacione nga Gjykata Themelore Civile, se janë gjithsej pesëdhjetë e katër lëndë aktive për veprat e ofendimit dhe shpifjes, në të cilat si palë paraqitet ndonjë gazetar apo media.

Organet shtetërore kanë vendosur sisteme për mbledhje të të dhënave kualitative statistikore, në mënyrë që të pengohet mosndëshkueshmëria

Rezultati për vitin 2021: 3.41 / Rezultati për vitin 2022: 3.41


Gjendja në krahasim me vitin e kaluar nuk ka ndryshuar. Gjykatat dhe institucionet kompetente edhe përkundër iniciativave të SHGM-së nuk kanë vendosur ende sisteme cilësore statistikore, në bazë të së cilave mund të japin të dhëna të sakta për të gjitha proceset gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët apo mediat.

Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka vendosur një regjistër të të dhënave statistikore për sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. As Gjykata Civile dhe as ajo Penale në Shkup nuk janë në gjendje të japin informacione të detajuara në lidhje me lëndët ku gazetarët paraqiten si palë në procedurë. Bazat e të dhënave të gjykatave nuk lejojnë kërkimin e të dhënave sipas kriterëve të ndryshme. Arsyeimi i tyre është se sistemi i ri i menaxhimit të lëndëve (AKMIS) bazohet në kode, jo në emra dhe profesione të palëve.

IV

Siguria fizike

4,09



40

Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë lidhje me sigurinë fizike

Rezultati për vitin 2021: 3.97 / Rezultati për vitin 2022: 3.87

Edhe pse në vitin 2022 kishte një përmirësim të lehtë sa i përket numrit të sulmeve nga kjo kategori, shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj të sulmeve, është ende e lartë në vend. Ndryshe nga viti 2020 dhe viti 2021, kur SHGM regjistroi shtatë dhe tri sulme të këtij lloji, në vitin 2022 u regjistruan vetëm dy sulme ndaj gazetarëve. Megjithatë, prej dhjetë sulmeve që ndodhën në dy vitet e mëparshme, në vitin 2020 dhe në vitin 2021, vetëm dy nga ato kanë përfunduar me epilog gjyqësor.

- Sulm verbal dhe fjalë nënçmuese të drejtuara ndaj gazetares Maja Jovanovska në kërkesën që ti përgjigjet pyetjeve të saj, nga Sadredin Elezosi, udhëheqësi i Departamentit për Urbanizëm në Komunën e Mavrovës Rostushë,
- Punëtorët e Drejtorisë së Higjienës Komunale Shkup, kundër vullnetit të dy gazetarëve Furkan Saliu dhe Avni Tahirit, i mbajtën ata në ambientet e institucionit. Në vitin 2021, kishte përmirësim të lehtë në kontekstin e këtij lloji të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vend, ndryshe nga viti 2020 kur SHGM regjistroi shtatë të tilla.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se nga gjithsej 10 sulme të kësaj kategorie të cilat kanë ndodhur në vitin 2020 dhe në vitin 2021, vetëm për një pjesë të tyre janë iniciuar procedura, pra vetëm për dy nga ato ka epilog gjyqësor. Kjo tregon se edhe krahas uljes së numrit të sulmeve të këtilla gjatë vitit 2022, sanksionimi i tyre është jo efektiv.

Kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Rezultati për vitin 2021: 3.93 / Rezultati për vitin 2022: 3.69

Në këtë indikator vërehet përkeqësim i theksuar i gjendjes, para së gjithash për shkak të sanksionimit joefektiv të kërcënimeve që kanë ndodhur gjatë viteve të kaluara. Prej katër kërcënimeve të llojit të këtillë, vetëm në njërin prej rasteve janë ndërmarrë veprime nga prokuroria dhe procedura është ende e papërfunduar. Krahasuar me vitin 2021, kur SHGM regjistroi vetëm një kërcënim, në vitin 2022 kishte dy kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë së gazetarëve.

- Kërcënimi eksplisit me vdekje drejtuar gazetarit Furkan Saliu në rrjetin social Twitter.
- Në shkollën e mesme "7 Marsi", gazetari Nevri Ademi derisa po priste për të regjistruar një kronikë me drejtorin e kësaj shkolle, nga një person i panjohur i është marrë telefoni dhe i është larguar mikrofoni. Pas kësaj, menjëherë i njëjti person, duke përdorur gjuhë të vrazhdë, ka tentuar ta shtyjë gazetarin jashtë në oborrin e shkollës.

Gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021 kanë ndodhur katër sulme të këtij lloji dhe vetëm në një rast është inicuar procedurë nga prokuroria. Bëhet fjalë për një rast të vitit 2021, kur një person fizik ka dërguar kërcënim serioz për disa online media, nga profili i tij në Facebook. Megjithatë, procedura ende nuk ka përfunduar deri në fund të vitit 2022. Kjo tregon se edhe kërcënimet serioze ndaj gazetarëve në vend vazhdojnë të sanksionohen në mënyrë joefektive.

Sulmet fizike

**Rezultatet për vitin 2021: 4.25 /
Rezultatet për vitin 2022: 4.25**

Krahasuar me vitin 2021, kur SHGM regjistroi vetëm një sulm të këtij lloji, në vitin 2022 ka pasur rritje të numrit, pra janë regjistruar tre sulme të këtij lloji. Por në vitin 2022 kemi një praktikë pozitive me zhvillimin e hetimit dhe veprimin e autoriteteve gjyqësore, për dallim nga dy vitet e fundit 2020 dhe 2021, kur për tre sulme të raportuara nuk kishte asnjë epilog gjyqësor.

- Sulm fizik me sëpatë ndaj gazetarit Nevri Ademi dhe kameramanit Zbulim Maksuti.
- Sulm fizik para shtëpisë së pronarit të portalit nga dy persona të maskuar.
- Sulm verbal dhe fizik ndaj kameramanit Ljubisa Ignatov nga ana e Mile.P, pronar i shtëpisë ku jeton Oleksandr Onishchenko.

Për rastin e gazetarit Nevri Ademi dhe kameramanit Zbulim Maksuti ishte ngritur procedurë hetimore dhe më pas edhe procedurë gjyqësore, e cila ka përfunduar me aktvendim gjyqësor për sulmuesin. Megjithatë, tre rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve nga viti 2020 dhe viti 2021 nuk janë hetuar dhe sanksionuar nga ana e organeve gjyqësore.

– INDIKATORI 4.4

Kërcënime dhe sulme ndaj medieve dhe shoqatave të gazetarëve

Rezultati për vitin 2021: 4.53 / Rezultati për vitin 2022: 4.53

**SHGM nuk regjistroi asnjë sulm të këtij lloji në vitin 2022.
Krahasuar me vitet e mëparshme në këtë dimension,
situata mbetet e pandryshuar për këtë tregues.**

Titulli
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor
Republika e Maqedonisë së Veriut – Raport narrativ i vitit 2022

Botues
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



Autor
Millan Spirovski

Ekspert juridik
Ivan Breshkovski

Ekspert mediatik
Marina Tuneva

Lektor
Maja Katarova-Apostollova

Dizajn
comma.rs

Ky publikim është përgatitur me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian dhe Civil Rights Defenders. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe Civil Rights Defenders.

